



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E

VLERESIMIT TE NDIKIMIT

NE MJEDIS PER SUBJEKTIN:

“BLERIMI KOSTURR 2010 ” SH.P.K

“Industria minerare, ID 3.7 Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret”



Subjekti: “Blerimi Kosturr 2010 ” sh.p.k

Aktiviteti: “Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret”

Vendndodhja: Objekti “Macaj-Perrollaj”, rrethi Has, Qarku Kukës

Pergatiti materialin : “Eko-Studio-Projekt” sh.p.



Tirane, 2023



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE


Relacioni u pergatit nezbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti “Blerimi Kosturr 2010 ” sh.p.k me administrator Z. Bujar Meshri dhe Z. Hasan Meshi eshte regjistruar prane QKR me NIPT L07525201B. Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte Objekti “Macaj-Perrollaj”, rrethi Has, Qarku Kukës. Subjekti ushtron aktivitetin Shfrytezimit me karriere te kromit. Subjekti ushtron aktivitetin “Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret” i pajisur me Leje Minerare Nr. 1629, zona 168/1 per shfrytezim mineralit te Kromi.



Nr.	X	Y
1.	4442500	4679500
2.	4442500	4680500
3.	4443500	4680500
4.	4443500	4679500
5.	4443207	4679296
6.	4443081	4679500

Siperfaqja totale e sipas Lejes Minerare me Nr. 1629, zona 946/1 eshte 1.042 km².

Sistemet e shfrytezimit ne siperfaqe, klasifikohen sipas menyres se transportit te mbuleses ne stiva, menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit dhe tipit te pranuar te mjetit te ngarkimit dhe transportit, ato klasifikohen:

- Sisteme shfrytezimi pa transport



- Sisteme shfrytezimi me transport
- Sisteme te kombinuara te shfrytezimit

Nga analiza qe u kemi bere ketyre tre sistemeve dhe krahasimi, kemi zgjedhur per te aplikuar sistemin e shfrytezimit me transport i cili ka keto prioritete:

Eshte sistem universal pasi i pershtatet cfaredo kushti ne shtrirje te vendburimit, shumellojshmerise se relievit te siperfaqes dhe cfaredo fortesie te shkembinjve.

Sterili qe do te dale nga punimet e zbulimit, do te ngarkohet ne automjet me ane te mjetit te ngarkimit dhe do te transportohet ne vend depozitimet brenda kufijve te karrieres.

Shfrytezimi parashikon fillimin e punimeve nga larte poshte (horizonti i siperm drejt horizontit te poshtem). Kjo menyre shfrytezimi lejon zhvillimin normal te punimeve te shfrytezimit duke krijuar siguri ne pune si dhe krijon mundesi per shfrytezim te njekoheshem ne disa shkalle. Horizontet dote zhvillohen sipas izoipseve te terrenit.

Punimet e zbulimit

Ne fazen e pare dote pergatitet siperfaqja qe dote shfrytezohet. Nga verifikimi ne terren rezulton qe ne zonen qe dote kryhen punime zbulimi dhe rreth saj nuk ka infrastrukture te ngritur si ndertesa, linja tensioni etj duke thjeshtuar procesin e cvendosjes se tyre. Proceset kryesore ne kryerjen e punimeve te zbulimit jane: rrezimi, ngarkimi, transporti dhe stivimi i shkembinjve. Ne kapitullin e llogaritjes se rezervave eshte parashikuar qe te shfrytezohen rezervat nga horizonti +490 m deri ne siperfaqe duke levizur 168128 m³ steril per ne stiva.

Elementet e sistemit te shfrytezimit

- Lartesia e shkalles 10 m
- Kendi i skarpates se shkallve 70 - 72°
- Gjeresia e shkalleve te sigurise 3 m
- Ngarkimi dhe transporti - te mekanizuar
- Rrezimi i mineralit- me perdorimin e lendes plasese
- Thellesia maksimale e karrieres 35 m
- Numri i shkalleve 4
- Gjeresia e shesheve te punes 5-18 m
- Drejtimi i shfrytezimit nga qendra ne kufi dhe e kombinuar
- Radha e shfrytezimit nga larte poshte

Radha e shfrytezimit do te jete nga lart poshte. Drejtimi i shfrytezimit pergjithesisht do te jete nga kufiri ne qender. Shfrytezimi ne cdo horizon! dote filloje ne gjysem transhete e shkurtra te cdo horizonti te cilat sic theksuam tek varianti i hapjes, ato do te fillojne krahas ndertimit te rruges. Transhete do te hapen me gjysem seksioni deri ne kufinjte perfundimtare te shtrirjes ne zonen qe shfrytezohet. Kapaciteti i prodhimit eshte pranuar 7600 ton/vii me regjim pune drite ne drite. Kapaciteti vjetor 7600 t/vit



Kapaciteti mujor	633 ton
Kapaciteti ditor	29 ton
Dile pune ne vit	264
Dite pune ne muaj	22

Humbjet dhe varferimi i mineralit jane pranuar 5% ndersa thellesia e karrieres nga kuota me e larte eshte 40 m (blloku 1). Shkembinjte do te stivohen ne sheshet e percaktuara ne planimetrine me sheshet e depozitimit (ana grafike).

Punimet e prodhimit

Menyra e marrjes se shkal/eve dhe nenshkalleve

Terreni i karrieres ku pjerresia nuk eshte shume e madhe krijon mundesi per kryerje zbulimi dhe prodhimi njekohesisht ose kryerjen e zbulimit paralelisht ne te gjitha lartesine e shkalles prej 10 meter, te ndare ne 5 feta me lartesi 2m. Fillimisht kryhet zbulimi ne feten 1 deri sa zbulohet tavani i trupit. Ne mbarimin e zbulimit ne feten e pare fillon prodhimi i mineralit ne kete fete, nderkohe fillon zbulimi njekohesisht ne fetat 2, 3, 4 dhe 5, ballet e te cilave ne menyre te sinkronizuar zhvendosen detyrimisht me nje hap avancimi te diferencuar nga njeri tjetri jo me pak se 3 m, ose balli i avancimit te fetes 2 te jete jo me pak se 3 m para avancimit te ballit te fetes 3 e keshtu me rradhe. Gjate shfrytezimit te fetes 1 zbulohen revat ne feten 2, rradhazi deri te feta 5. Me shfrytezimin e fetes 5 krijohet skarpata ne gjendjen perfundimtare e cila ne rastin konkret eshte sa kendi i renies se trupit mineral qe njekohesisht eshte dhe kendi i shuarjes se skarpates ne gjendje perfundimtare. Sipas kesaj skeme teknologjike prodhimi e zbulimi krijohen mundesi per te punuar njekohesisht ne disa fronte pune ne zbulim e prodhim, shfrytezim racional te kohes se punes te minatorit, zjarmetarit dhe manovratoreve qe jane parashikuar per te punuar ne kete objekt.

Gjeresia e sheshit te punes

Ne rastin e perdorimit te transportit automobilistik gjeresia e sheshit te punes ne shkalle mund te llogaritet si me poshte. Ne rastin kur automjeti e ben kthesen ne ane te ekskavatorit gjeresia minimale e sheshit te punes diktohet nga:

- A-gjeresia e hyrjes se ekskavatorit
- C-largesia ndermjet buzes se poshteme te mases se shkrikeruar te shkembbit ose buzes se poshteme te shkalles dhe aksit te rruges se levizjes se automjeteve
- R - rrezja e ktheses se automjeteve
- C1 - largesia nga aksi i rruges deri te linja e shembjes se mundeshme te shkalles (brezi i sigurise)
- B - Gjeresia e brezit te sigurise mbi te cilin ndalohet vendosja e paisjeve te shpimit, transportit dhe ngarkimit

$$L1 = A + C + 2R + C1 + B$$

$$A \leq 1.5 R_{ke} = 11 \text{ m}$$

$$C = K/2 + 1 = 3/2 + 1 = 2.5$$

K - Gjeresia ekarrocere se mjetit te transportit e pranuar 3m

$$R = 1,2R_{min} = 1.2 \times 10 = 12 \text{ m}$$



R_{min} - rrezja minimale e kthimit e pranuar 10 m

$$C1 = K/2 + 1.5 = 3/2 + 1.5 = 3m$$

$$B = H(\cot\beta/3 + \cot\alpha) = 10(0.509 - 0.364) = 1.45 m$$

H - lartesia e shkalles

β - kendi i qendrueshmerise se shpatit i pranuar 63°

α -kendi i pjerresise se shpatit te shkalles i pranuar 70° ne perfundim kemi."

$$L1 = A + C + 2R. C1 + B = 11 + 2.5 + 24 + 3 + 1.65 = 44.95$$

Gjeresia e hyrjes ne shkembenj te forte varet nga numri i rradheve te puseve te minave, i cili ne rastin e ketij projekti rekomandohet te jete dy ose tre. Per vendosje te puseve ne nje rradhe, gjeresia e hyrjes ne masiv eshte e barabarte me vijen e rezistences mete vogel marre ne dysheme te shkalles. Ne rastin eketij projekti kemi:

$$A = W + (n-1)L1 \quad \text{ku:}$$

W - vija e rezistences me te vogel

W1 - largesia ndermjet rradheve te puseve ($W1 = a$)

a- largesia ndermjet puseve te minave ($a = mw$)

m - koeficienti i afrimit te ngarkeses se minave, ne rastin konkret pranohet 0.6 – 0.8

Gjeresia e brezit te shkrikeruar fillon nga buza e poshteme e shkalles ne te cilen plasmin minat, deri ne afersi te aksit te rruges ku levizin mjetet e transportit dhe percaktohet me matje te drejtperdrejte ose llogaritet:

$$X = A \left(2Ksh \frac{H}{h} - 1 \right) \quad \text{ku:}$$

Ksh - koeficienti i shkrikerimit te shkembenjve

H - lartesia e shkalles

H - lartesia e mases se shkrikeruar pas plasjes se minave ($h = 0.8 - 0.9$)H

Largesia nga buza e poshteme e mases se shkrikeruar ose buzes se poshteme te shkalles dhe aksit te rruges se levizjes se auomjeteve llogaritet:

$$C = \frac{K}{2} + 1 \quad \text{ku : K - gjeresia e karrocere se automjetit}$$

Rrezja e ktheses se automjetit

Rrezja e ktheses se automjetit llogaritet me formulen:

$$R = 1.2R_{min}$$

R_{min} - Rrezja minimale e ktheses se automjetit

Per automjete me aftesi transportuese:

- 4 - 5 ton rrezja minimale eshte 8.5 m
- 10 ton rrezja minimale eshte 105 m



– mbi 30 ton rezja minimale eshte 12 m

Largesia nga aksi i rruges se /evizjes se automjeteve deri te vija e brezit te sigurimit llogaritet:

$$C1 = \frac{K}{2} + 1.5$$

Gjeresia e brezit te sigurise, mbi te cilat ndalohe vendosja e mjeteve te transportit llogaritet:

$B = H(\cot\alpha - \cot\beta)$ ku:

β -Kendi i qendrushmerise se shpatit te shkalles ($35^\circ - 60^\circ$)

α - Kendi i pjerrtesise seshpateve te shkalles ($65^\circ - 80^\circ$)

Me siper trajtuam nje skeme te levizjes se automjeteve

Eshte detyra e drejtuesit teknik te karieres qe te llogarise ne cdo rast gjeresine e sheshit te punes sipas skemave kur automjeti leviz ne nje drejtim, kur ngarkimi dhe transporti behen ne sheshe te ndryshme. Pavarsisht nga skema e levizjes se automjeteve, afrimi i tyre prane ekskavatorit duhet te kryhet ne drejtim te kundert me levizen e tij ne menyre qe gjate ngarkimit, kova te mos kaloje mbi kabinen e shoferti. Gjeresia e shesheve te punes ne shkembjenj te forte luhetet nga 12-13 m deri ne 30 - 35 m.

Punimet e rrezimit ne prodhim e zbulimin e mineralit

Fortesia e shkembjenjve sic u parashtrua me larte eshte e tille qe ben te domosdoshem perdorimin e punimeve me lende plasese. Prodhimi i mineralit ne karriere eshte projektuar 9700 ton/vit, duke rezervuar te drejten e shoqerise qe ne funksion tekerkesave te tregut te argumentojne rritjen e vellimit te prodhimit ose ne mungese tregu uljen e tij, ne programet vjetore qe harton dhe miraton ne organet pergjegjese.

Ne projekt pashaportat e shpim plasjes i jane referuar sigurimit te prodhimit mineralit prej 9700 ton ne vit dhe zbulimit prej 35000 m³ /vit.

Punimet e shpim-plasjes ne prodhimin e mineralit diktohen nga keta faktore:

- Domosdoshmeria e perdorimit te lendeve plasese per rrezimin e shkembjenjve me
- Fortesi mbi-mesatare.
- Karakteristikat gjeomekanike te pakos produktive

Ne funksion te ketyre faktoreve jane projektuar dy pashaporta shfrytezimi :

- Per fazen fillestare te hapjes se gjysem transheve dhe ricoptimin e materialit
- Prodhuar, shpimi i birave dote behet me cekic shpues pneumatik dare.
- Per sigurimin e prodhimit ditor shpimi i birave dote behet me puse sondash me
- Diameter 100m/m.
- Ne raste te rrezimit me bira sonde parametrat e pasaportes se shpim-plasjes
- Paraqiten ne vizatimin me pasaporten e shpim plasjes.



- Rrezimi me dhoma minash nuk rekomandohet ne projekt, mbasi pervoja e deritanishme e krijuar ne vendin tone ka treguar qe perdorimi i kesaj metode ka sjelle deformimin ne zbatim te sistemit shfrytezimit duke krijuar premisa per pune jo te sigurte per jeten njerezve.

Rrezimi me bira marteli

Rrezimi me bira marteli i rekomandohet shoqerise qe te perdoret ne hapjen e rrugeve dhe transeve, pergatitjen e fillimit te shkalles, nivelimin e shesheve te punes, ricoptimin e mineralit me permasa te medha. Kjo metode perdoret edhe per rrezimin e mineralit ne kariera me kapacitet te vogel prodhimi e zbulimi, deri ne kufirin e leverdise ekonomike kur lind nevoja e perdorimit te mekanizmave.

Kushtet e punes:

- Lartesia e shkalles 10 m
- Lartesia e nenshkalles 2-2.5 m
- Gjatesia e bires 2.4 ml
- Diametri i bires 38-42 mm
- Kendi i skarpates 70-72^o
- Fortesia e shkembit 5-7
- Gjatesia e ciklit 20-25 m

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita gjeografike

Qyteti i Kukësit shtrihet në pjesën verilindore të Republikës së Shqipërisë. Është qytet që kufizohet në Veri-Lindje dhe Lindje me qytetin e Prizrenit (Kosovë) ku si pikë kontakti është dogana e Morinës, dhe në brendësi të territorit Shqiptar kufizohet me Hasin në veri, [Pukën](#) në perëndim dhe Peshkopinë në Jug. Kukësi ose Kukësi i Ri është vendosur në këmbë të malit të Gjallicës (2487 m) dhe është një ndër qytetet më të reja në Shqipëri. Përfundoi së ndërtuari në vitin 1976, dhe vendin e Kukësit të Vjetër e zuri hapësira ujore prej 72,5 km² e liqenit artificial të Fierzës, i cili u ndërtua si rezultat i ndërtimit të Hidrocentralit me po të njëjtin emër. Baseni i këtij liqeni furnizohet nga dy lumenj të rëndësishëm, Drini i Zi (buron në liqenin e Ohrit) dhe Drini i Bardhë (buron në Malet e Rugovës, Kosovë), të dy këto degë formojnë Lumin Drin, më të gjatën në Shqipëri me 280 km i cili derdhet në Detin Adriatik nëpërmjet Gjirit të Lezhës. Bashkimi i dy Drinave i kanë dhënë Kukësit formën e një gadishulli, gjë që i jep një pamje shumë piktoreske. Ka një shtrirje veri-jug prej 1,4 km dhe lindje-perëndim prej 0,9 km. Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 150 ha dhe lartësi mesatare 320-350 m mbi nivelin e detit.

Kushtet klimatike

Klima karakterizohet nga një dimër i ashpër dhe një verë e nxehtë. Temperatura mesatare vjetore në rrethin e Kukësit sillet rreth 11,9 °C. Temperaturat mesatare ekstreme sillen nga



3,9 deri 25,4 °C. Reshjet vjetore mesatare sillen nga 800 deri në 1100 mm. Shpejtësia mesatare e erës është 3,5 m/s në dimër, 3,1 m/s në pranverë dhe 2,3 m/s në vjeshtë. Trashësia e shtresës së borës është në varësi të drejtpërdrejtë me lartësinë mbi nivelin e detit dhe nga ekspozimi i shpateve. Zakonisht ajo lëviz nga 40 cm deri në 200 cm. Shtresa e dëborës mesatarisht zgjat 35-40 ditë.

Hidrografia , Hidrogeologjia

Te vetmet burime qe takohen jane disa kroje me debit shume te ulet te cilet edhe ne kohe reshjesh sjellin pak uje ne minute. Burimet e ujerave nentokesore qe dalin ne sipërfaqe lidhen me kontaktin e shkëmbinjve gelqerore dhe zones se mineralizuar te kores se prishjes e cila ne kete rast sherben si ekran i ujerave nentokesore. Nga te dhenat e mbledhura ne rajon ka nje regjim ujerash te paqendrueshem, shumica e te cilave eshte ne varesi te reshjeve. Gjate veres disa nga keto burime, kroje, shterojne.

Flora dhe fauna

Kafshët që rriten në zonën e Hasit janë të përshtatura më klimën dhe bimësinë të cilat më të përhapura janë Ahu, Qarri, Bunga, Plepi, Blini, Shkoza Mulleza, Farsheri, Lajthia e egër etje dhe me pak janë të përhapura haloret. Janë të përhapur kafshët e egra si (lepuj, dhelpra, ujku, derri i egër, ariu, kaprolli, dhija egër, macja e egër etj) dhe shpend të egër si thellenxa, shqiponja, pëllumbi, skifteri, harabeli, mullëza, etj. Shfrytëzimi i pyjeve të dushkut, (Dushkajën e Hasit) dhe i resurseve natyrore, thjeshte për nevojat ekonomike, si rruga me e lehte dhe pa shpenzime, çoi në dëmtime të konsiderueshme. Me planifikimin e centralizuar u shfrytëzuan miliona metër kub lende druri për ndërtimet e minierat, dru zjarri për ngrohje e gatim, u hapen toka të reja në pyjet më të mira (rreth 5500 ha).

Gjeologjia

Produktet laterike ne rajonin e Kukesit perhapen ne trajten e nje brezi me gjatesi 2-10km dhe me gjeresi rreth 45 km (ne vije ajrore) me drejtim verilindje-jugperendim, por me nderprerje, duke formuar sheshe te vecanta. Ne pjesen jugore shfaqen ne kufi me masivin ultrabazik te Lures ne afersi te fshatrave Rep Prenaj, Nome dhe Perroi Molle e Lures. Xeheroret lateritike me ne veri ndodhen poshte trashesise karbonatike te Kretakut te poshtem ne zonen e Arrit. Me tej ato shfaqen ne lindje te Qafes se Komit e ne perendim te fshatit Aliaj si dhe ne Malin e Madh. Objekti i kerkuar ben pjese ne masivin ultrabazik te Kukesit (ne kontaktin e shkëmbinjve ultrabazik me gelqeroret e triasit siperm).

Masivi ultrabazike i Kukesit ndodhet ne pjesen me veri-lindore te brezit lindor te ofioliteve shqiptare. Ne pjesen perendimore dhe jugperendimore ky masiv kalon nepermjet llojeve kalimtare ne masivin gabror te Kaptines.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikesht ndikimet e cdo operacioni te kryer.



- **Ndikimet ne popullsi**

Ushtrimi i aktivitetit do te kryhet larg zonave te banuara, rreth 733 km nga banesa me e afert. Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesimit te tyre, duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve qe ndodhen ne fshatin prane.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat qe krijohen jane si rezultat i makinerive qe perdoren per transport, zhurma te tjera nuk ka gjate zhvillimit te aktivitetit, dhe sic e permendem me lart eshte larg zonave te banuara .

- **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Nga gjenerimi i ketij aktiviteti nuk ka shkarkime ne ujera.

- **Ndikimet ne toke**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngurta te cilat te perbejne rrezik per ndotjen e tokes, te vetmet mbetje qe gjenerohen jane ato qe vijne nga aktiviteti personal i punonjesve te cilat shkojne ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.

- **Ndikimet ne ajer**

Duke qene se kemi te bejme me nje aktivitet karriere, kemi nje gjenerim te pluhrave ne ajer por qe nuk shkaktojne ndotje te nje niveli shqetesues. Per ta evituar, here pas here subjekti ben sperkatje me uje te territorit.

- **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit, ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

- **Ndikimet ne perdorimin e tokes**

Aktiviteti ne fjale eshte i pajisur me nje leje minerare, dhe per kete arsye ne perfundim te shfyttezimit te kesaj siperfaqe toke, do beje rehabilitimin e saj. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne perdorimin e tokes, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar per kete qellim.

- **Ndikimet ne ekonomi**

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth rrit nivelin e tyre te jeteses. Mund te themi qe mineralet qe perftohen nga ky aktivitet mund te perdoren si lende te pare per procese te tjera ne sektorin e ndertimit dhe per kete arsye eshte nje aktivitet qe ka ndikime pozitive ne ekonomine e vendit tone.



4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Masat qe duhen marre per eleminimin/minimizimin e ndotjeve.

Ndikimi i mundshem	Masat e marra
1 Ndikimet ne toke (menaxhimi i mbetjeve sterile)	Nga kryerja e punimeve del nje volum i konsiderushem sterile. Keto sterile transportohen me kamiona dhe depozitohen jashte kufijve te karieres ne sheshin e depozitimit, keto sterile perdoren per rehabilitimin e siperfaqeve te shfrytezuara. Persa i perket mbetjeve urbane te cilat jane mbetjet e gjeneruara nga stafi i punojsve keto do te grumbullohen ne vendet e percaktuar nga subjekti per tu derguar me pas ne vendet e percaktuara nga pushteti vendor.
2 Humbja e tokes per kullote	Siperfaqe e pergjithshme qe do te zeje objekti i shfrytezimit nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson ndonje kullote. Ne perfundim te shfrytezimit do te behet mbushje me sterile te hapsirave te krijuara nga kryerja e punimeve te zbulimit dhe te shfrytezimit. Hapsirat e krijuara ne karierat nga kryerja e punimeve te shfrytezimit kryesisht do te mbushen me sterilet e depozitimeve qe gjenden ne vendburim, ndersa ne pjesen e siperme do te mbushen me toke produktive. Do te behet depozitimi dhe sistemimi dheut produktiv me trashesi rreth 60 cm mbi siperfaqet e mbushura me steril. Shfrytezimi i objektit nuk ze toka buke dhe prish pyje dhe kullota.
4 Ngjeshje e pjeseshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe te automjeteve te transportit si kamione etj.	Ngjeshja e tokes nga mjetet e punes gjate shfrytezimit si dhe nga levizja e mjeteve te transportit te mineralit dhe sterilit. Te cilat do te transportojne sterilet per ne sheshin e sterileve si dhe lenden e pare.
6 Vibracion si pasoje e shfrytezimit.	Do te jete nje vibracion normal teknologjik i cili duhet te jete i ndjeshem vetem ne zonen ku shfrytezohet.



Masat e marra per minimizimin e ndikimeve negative ne ajer

Ndikimi i mundshem	Masat e marra
1 Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet, ngarkim transportit.	Saisa e gazeve e NOx dhe SOx qe do te shkarkohet eshte standart i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara. Mjetet jane te kolauduara dhe shkarkimet e kesaj natyre jane minimale.
2 Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes.	Objekti eshte i distancuar nga qendra e banuar, keshtu qe niveli i zhurmave nuk do te krijoje probleme per banoret. Gjithsesi operaconet e punes do te jene te limituara ne kohe. Do te punohet me nje turn.
3 Sasi pluhuri si pasoje e shfrytezimit te karrieres, pasi shfrytezimi brenda ne miniere nuk gjeneron pluhura ne ambjentin e jashte saj dhe qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit dhe sterililit.	Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesoje kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle. Ne kohe te thate do te behet lagia e siperfaqes ku po punohet si dhe e rrugeve te qarkullimit te mjeteve.

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve negative ne uje

Ndikimi i mundshem	Masat e marra
1 Shkarkimet e ujrave	Ne teknologjine e shfrytezimit me karriere siperfaqesore nuk perdoret uji.

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve ne floren e zones

Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1 Shqetesim i flores ne zone	Siperfaqja e karrieres perreth saj eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht dhe fauna eshte e varfer proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Nga shfrytezimi do te kemi largim te siperfaqes se tokes me bimesi, ne pergjithesi takohen shkurre dhe bime barishtore. Siperfaqja e prekur do te mbillet me bime lokale ne momentin kur te behet rehabilitimi i siperfaqes qe shfrytëzohet. Rehabilitimi behet ne menyre progresive.

Masat e marra per menaxhimin e mbetjeve te ngurta

Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1 Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Kartona, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve. Leter dhe karton- 20 01 Mbetje te biodegradueshme-20 01 08 Plastikat- 20 01 39



Keto mbetje do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga drejtuesit e shoqerise per tu derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.

Kushtet e punes

Investitori ka krijuar kushte te favorshme pune per punonjesit e tij. Per te permbushur sigurine e punetoreve ofron kushte te mira pune, punetoret jane te pajisur me uniforma. Stafi eshte me eksperience ne kete fushe. Janë marrë masa për sigurimin teknik dhe sistemimin e ambienteve të punës

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Realizimi i objektiveve dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne ne siperfaqe te pastra, te sistemuara e te gjelberuara.

5. KONKLUZIONE

❖ Konkluzione

- Zbatohen rregullat e sigurimit teknik. Punetoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesi teknik te firmes.
- Mbajtja paster e mjedisit te territorit, eshte detyre e perhershme ne menyre qe te sigurohet nje mjedis sherbimi i kulturuar dhe cilesor.
- Vlerësohet puna e bërë nga drejtuesit e ketij subjekti.
- Riparimet e mjeteve te renda dhe atyre te transportit kryhen ne vende te vecanta duke marre masa per uljen e ndikimit ne mjedis dhe per te mos lejuar kontaminimin mjedisor me mbetje te lubrifikanteve.

❖ Rekomandime

- Te vazhdohet te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen ambientet e punes.
- Te vazhdohet te kryhet rregullisht kontrolli i gjendjes teknike te agregateve teknologjike te mbrojtjes se mjedidit dhe mjeteve te transportit..
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.